



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:000274

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06904619

**C.nr. 17/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Agron Karatash, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorin profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.L. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ....” me avokatët nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti kompensimin pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,000.00 (njëmijë) euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 26.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. LAPROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia** e paditësit N.L. dhe DETYROHET e paditura Sh.S.K.U.K.- Spitali Rajonal në Prizren, që paditësit në emër të kompensimit dy pagave jubilarë për 20 vite të përvojës në punë, të ia paguaj shumën prej 155,00 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë euro), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë (datë 05.01.2022), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e shumës së kërkuar me kërkesëpadi,** përtej shumës së aprovuar si nën I të Dispozitivi të këtij Aktgjykimi, përkatësisht shuma prej 74.48 Euro.

**III. DETYROHET e paditura SHSKUK-Spitali Rajonal në Prizren,** që paditëses të i'a paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumën prej 134,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi N.L. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ....” me avokatët nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. –Spitali Rajonal Prizren, për shkak të kompensimit të pagave jubilarë. Në padi ka deklaruar se paditësi është në marrëdhënie të punës tek e paditura me mbi 20 vjet përvojë pune. Duke marrë parasysh dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale paditëses i

takon kompensimi për dy paga jubilarë. Lartësia e pagës mbështetet në realizimin e pagës së fundit të paditëses. E paditura nuk ka vepruar sipas këtij detyrimi ligjor, Prandaj paditësja e ka parashtruar këtë padi përmes së cilës kërkon nga kjo gjykatë që pas administrimit të provave të merr aktgjykim përmes së cilit do ta aprovonte në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Paditësi kërkesën e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në nenin 52 dhe 53 e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Me dispozitat nga par.3 të këtij neni është paraparë që shpërblimet jubilarë të paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushtit nga ky paragraf, kjo do të thotë se shpërblimet jubilarë paguhet në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuar i mbush 10, 20 dhe 30 vjet përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut. E paditura ka kundërshtuar në tërësi edhe shumën e kërkuar nga pala paditëse, sepse nuk është llogaritur paga bazë, por në mënyrë paushalla janë cekur vlerat nga sindikata për të gjithë punëtorët e spitalit dhe në rastin konkret paditësi pagën bazë e ka 577.50 euro e jo 6414.74 euro sepse në vlerën e 614.74 euro janë të llogaritura edhe kujdestaritë. Në rastin konkret duke u nisur nga fakti se paditësi marrëdhënien e punës tek i paditura e ka themeluar më datën 01.09.2000 mund ta konstatojmë paditësi tek e paditura 20 vjet përvojë pune i ka mbushur me datë 01.09.2020, andaj ky vit për të ka qenë jubilar, pra viti kur MPKK nuk ka qenë në fuqi, gjithashtu MPKK nuk përmban dispozitat të efekteve retroaktive, para se të hy në fuqi i njëjti, andaj sipas kësaj paditësit nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar dhe për këtë arsye kërkojë nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit lidhur me shpërblimet jubilarë të vlerësoj si pa bazuar, gjithashtu paditësi Naim Lushaj shpërblimin jubilar për 10 vite të përvojës së punës e ka marrë me urdhër përmbarimore P.nr.2031/20 të datës 24.08.2022, prandaj duhet të theksohet se kemi të bëjmë për një pagë jubilarë e jo për dy paga siç pretendon pala paditëse. Në fund ka theksuar se paditësi kërkesëpadinë e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datë 10.06.2021. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e paditësve, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi N.L. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si infermier në Spitalin e Përgjithshëm “Prim Dr.Daut Mustafa” në Prizren.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 762 të datës 04.08.2023 gjykata ka vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës si infermier. Në spitalin e përgjithshëm Prim.Dr.Daut Mustafa në Prizren, ka gjithsej 22 vite e 11 muaj përvojë pune e cila përvojë është llogaritur deri me datë 31.07.2023 kurse paga e fundit bazë është 577.50 Euro, vërtetim ky i lëshuar nga shefi i personelit pranë të paditurës.

Vërtetimet në fjalë, Gjykata e pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë këto dokumente janë të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që

vërtetimet e lëshuara nga e paditura, si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur përvojën e punës dhe lartësinë e pagës që i njejtë realizon pranë të paditurës.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj), dhe me neni 4 paragrafi 1 i KKS përcakton se: *“KKS-ja gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”*

Me nenin 17 par. 3 nën 3.2 të KKS parashihet se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të 2 pagave mujore të tij”*, ndërsa par. 4 i këtij neni parashihet se *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Nga provat e cekura si më lartë dhe dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e pagave jubilarë, gjykata erdhi në përfundim se paditësi e ka të drejtën që të kërkojë nga e paditura kompensimin e pagave jubilarë për 20 vitet të përvojës në punë që ka pranë të paditurës.

Nga provat e administruara si më lartë dhe dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e shpërblimit jubilar, të cituara si më lart, gjykata erdhi në përfundim se paditësi e ka të drejtën që të kërkojë nga e paditura kompensimin e pagave jubilarë, për 20 vite të përvojës së punës. Duke qenë se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin i cili rrjedh nga kontrata e përgjithshme sektoriale për kompensimin e shpërblimit jubilar, siç parashihet me nenin 17 par. 3 pika 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKSSH), gjykata e detyroi të paditurën si nën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Provat bashkangjitur padisë dhe përgjigjes në padi e vërtetuan të drejtën e paditëses për të kërkuar këtë shpërblim jubilar, në rastin konkret dy paga jubilarë sepse plotësohen të gjitha kushtet e nevojshme ligjore. Punëdhënësi i fundit i paditësit është SHSKUK-Spitali Rajonal në Prizren. Paditësi ka mbi 20 vite të përvojës së punës, ndërsa sa i përket lartësisë e njejtë u vërtetua nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura dhe lartësia e pagës së paditëses është në shumën prej 577.50 Euro.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që gjykata e vlerësoi se paditësit i takon shpërblimi jubilar në lartësi të pagës bazë të përshkruar si në vërtetimin me numër 762 të datës 04.08.2023 e lshuar nga e paditura, dhe jo duke përfshirë shtesat që i ka pranuar nga e paditura.

Për të bërë përkufizimin se çka nënkupton pagë dhe pagë shtesë, gjykata i'u referua Ligji të Punës i cili në nenin 55 par. 2, parasheh se i punësuari: *“ ka të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuarit i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*. Në rastin konkret paditësi me rastin e parashtrimit të kërkesës e ka kërkuar pagën mujore në lartësi prej 614.74 €, por gjykata gjeti se në këtë shumë janë të përfshira edhe shtesat tjera të pagës, ndërsa paga mujore që ai realizon nga e paditura është shuma prej 557.50 Euro.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e të paditurës lidhur që paditësi ka marrë shpërblimin jubilar për 10 vite përvojë, ku gjykata gjeti se ky pretendim është i pabazuar. Kështu sipas nenit 17 par. 3 nën par. 3.3. të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, rrjedh se paditësit i takojnë dy paga mujore bazë, për 20 vjet të përvojës së punës. Pra edhe nëse paditësi ka marrë një pagë mujore bazë për 10 vjet përvojë pune ashtu siç thekson e paditura, kjo nuk e zhbën faktin se paditësit i takojnë dy paga jubilarë. Poashtu, pretendimi i të paditurës së kërkesëpadia e paditësit është jashtë afatit kohor të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, është i pabazuar dhe pa mbështetje juridike. Kësisoj, gjykata pas vlerësimit dhe shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, më konkretisht nga vërtetimi me numër 762 të datës 04.08.2023, vërtetoi faktin se paditësi 20 vjet përvojë pune i ka arritur më datë 01.09.2020, pra brenda periudhës kohore që ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë e datës 12.06.2018.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë me datë 05.01.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 449, 452 dhe 453 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 30.00 euro, gjithsej shumën prej 134.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:000274, 26.02.2025

**Gjyqtari,**

**Agron Karatash**

Numri i lëndës: 2022:000274  
Datë: 26.02.2025  
Numri i dokumentit: 06904619

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.